



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4, si dhe nenin 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 03 korrik 2023 vazhdim i mbledhjes së datës 29 qershor 2023, miratoi këtë;

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS – NISMËS SË BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIMIT ME KOMUNËN GRUBIŠNO POLJE NË KROACI

Neni 1

Miratohet kërkesa – nisma e z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar - binjakëzimit me Komunën Grubišno Polje në Kroaci.

Neni 2

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me përfaqësuesit e Komunës Grubišno Polje në Kroaci dhe përgatitjen e draft Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0045386/23
Podujevë, datë: 03 korrik 2023

